



V E N D I M
K.P.P. 633/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.09.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “A.M.U” sh.p.k, në procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Blerje matësa uji”, me nr. REF-70464-05-22-2018, me fond limit 16,910,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.06.2018, nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë sh.a.

Ankimues:

Operatori ekonomik “A.M.U” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Sokrat Miha”, Kompleksi Fratari, Godina 4, Dyqani 8, Yzberisht, Tiranë.

Autoriteti kontraktor:

Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë sh.a.
Adresa: Lagjia “Kushtrimi”, Rr. “Arkobaleno” Vlorë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 23.05.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Blerje matësa uji”, me nr. REF-70464-05-22-2018, me fond limit 16,910,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.06.2018, nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë sh.a.

II.2 Në datën 27.06.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 09.07.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "A.M.U" shpk,	12,366,400 lekë pa tvsh	Skualifikuar;
2. "Vibtis" shpk	13,523,288 lekë pa tvsh	Skualifikuar;
3. "Hidro Mentori" shpk	14,366,510 lekë pa tvsh	Skualifikuar;
4. "Novamat" shpk	14,600,250 lekë pa tvsh	Skualifikuar;
5. "Comfort" shpk	15,977,000 lekë pa tvsh	Skualifikuar;
6. "Fat Group" shpk	16,695,000 lekë pa tvsh	Kualifikuar;

II.4.Nga verifikimet e kryera, rezulton se operatori ekonomik "A.M.U" sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyen si më poshtë vijon:

"-Ne dokumentin me emer "Certifikata Aprovimi per perdorim uje te pijshem Itecon" ne faqen nr.2 nuk ka asnje te dhene mbi tipin e matesit qe eshte certifikuar per uje te pijshem. Rrjedhimisht nuk vertetohet se matesi ultrasonic ka certificate te ujit te pijshem.

-Nuk jane paraqitur manualet e matesave te perdorimit, ne dokumentin "Katalog+Specifika+zManual_Instalim" ne faqen 11 dhe 12 jane paraqitur disa foto te paqarta mbi montimin e matesit dhe jo manual perdorimi, per me teper qe keto foto nuk jane per te gjithë matesat e kerkuar nga Autoriteti Kontraktor.

-Nuk jan paraqitur certifikata MID per te gjithë matesat e kerkua nga Autoriteti Kontraktor.

-Ne dokumentin e paraqitur me emrin "Katalog+Specifika+zManual_Instalim" ne faqen 4, Q1 i matesit ultrasonic te ofruar eshte 40 litra per ore nderkohe qe eshte kerkuar te jete i barabarte ose me i vogel se 13 litra ne ore bazuar ne specifikimet teknik ne DST faqe 31.

-jetegjatesia e baterise se matesit ultrasonic te paraqitur nga OE si moster eshte 10 vjet nderkohe qe ne specifikimet teknike ne DST eshte kerkuar mimumi 15 vjet me bateri pa perdorur opsionin e transmetimit te te dhenave me vale sipas protokolleve EN 13757-4, OMS ose ekuivalente me te, dhe minimum 11 vjet ne rastin kur transmeton te dhenat me vale.

-Ne dokumentin e paraqitur me emrin "Katalog+Specifika+zManual_Instalim" ne faqen 7 ka paraqitur catalog per matesin TK-3C nderkohe si moster ka paraqitur nje mates modeli TK-5C.

-Modeli TK-5C i paraqitur si moster nuk eshte 1" sic eshte kerkuar nga AK-ja por nga verifikimi i KVO-se rezultoi ne permasat 1 ½ , pra nuk eshte paraqitur sipas specifikimeve teknike te kerkuara ne DST."

II.5.Në datën 12.07.2018 operatori ekonomik ankimues "A.M.U" sh.p.k., ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e këtij të fundit për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6.Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 922 Prot. datë 17.07.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "A.M.U" sh.p.k., duke mospranuar pretendimet e ngritura në ankesë.

II.7.Në datën 26.07.2018 operatori ekonomik ankimues "A.M.U" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në

autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Së pari, ne e kundërshtojmë paragrafin e parë të skualifikimit pasi e kemi plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor. Ne ju kemi paraqitur një certifikatë higjene nga Instituti Kombëtar i Higjenes në Varshavë, Poloni. Faqja e dytë e dokumentit “Certifikatë aprovimi për ujë të pijshëm Itecon”, që ju citoni është përkthimi i dokumentit të lëshuar nga Instituti Kombëtar i Higjenes në Varshavë, Poloni i cili vërteton se kompania “Baylan” i plotëson të gjitha normat higjeno sanitare. Çdo artikull që ajo prodhon nuk ka ndikime negative në shëndetin e njeriut kështu edhe matësat që janë produkt i kësaj kompanie. Pra, nëse është certifikuar kompania, rrjedhimisht janë certifikuar edhe produktet e saj sepse kompania certifikohet mbi aktivitetin dhe jo mbi emrin. Rrjedhimisht edhe matësat ultrasonic të cilët janë produkt i kësaj kompanie janë të certifikuar për përdorim pa ndikim në shëndetin e njeriut, në kontakt me ujin e pijshëm të destinuar për përdorim human. Në faqen 3 në faqe 5 dhe 7 të dokumentit “Certifikatë aprovimi për ujë të pijshëm Itecon” janë paraqitur certifikatat “Itecon” ku është verifikuar qartë që tipet e matësive dhe komponentëve përbërës të tyre të kompanisë “Baylan”, sipas këtyre certifikatave, janë të përshtatshme për të qenë në kontakt me ujin e destinuar për përdorim human pa asnjë lloj problematike për shëndetin.

Së dyti, ne e kundërshtojmë paragrafin e dytë të skualifikimit pasi e kemi plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor. Në dokumentat standarte të tenderit pjesa 2.3 Kapaciteti Teknik të shtojcës 9 është parashikuar: Pika 6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për mallin që ofron, i cili duhet të jetë në përputhje të plotë me specifikimet teknike. Pika 9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë manualin e përdorimit të matësive të ofruar. Për të përmbushur këto kritere ne kemi paraqitur dokumentin "Katalog + Specifikat + Manuale Instalimi". Në faqen nr.11 të këtij dokumenti, ne kemi paraqitur një manual të instalimit të këtij matësi në foto ku qartësisht evidentohet mënyra sesi ky matës duhet të montohet dhe pjesët që duhen për montimin e tij. Po kështu në faqen 12 kemi paraqitur manualin sesi të gjithë matësat e tjerë duhet të montohen. Pra kemi paraqitur me manual grafik sesi është mënyra e saktë e vendosjes së matësive për të marrë 100% matje efikase. Nëse ne shohim pikën 9 të DST vihet re se ju si autoritet kontraktor nuk e keni specifikuar faktin sesi duhej të paraqitej "Manuali" i shpjeguar në formë të shkruar, me pamje grafike shenja konvencionale, me forma audio-vizive, me trajnime të punonjësve apo me mënyra të tjera duke e lënë evazive, kështu ne kemi paraqitur një "Manual" me pamje grafike-shenja konvencionale. Përsa i përket pjesës tjetër të arsyes së skualifikimit në këtë paragraf theksojmë se manuali i paraqitur vlen për të gjithë matësat që ju keni kërkuar pasi ne kemi paraqitur matësa vetëm të një kompanie dhe ky është manuali që kompania na ka dërguar për matësat e saj.

Se treti, ne e kundërshtojmë paragrafin e tretë të skualifikimit pasi e kemi plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor. Ju thoni se ne nuk kemi paraqitur certifikatë MID për të gjitha llojet e matësive të kërkuar nga autoriteti kontraktor Pavarësisht pretendimit tuaj, bini në kontraditë pasi nga njëra anë thoni që ne nuk kemi paraqitur certifikatë MID për të gjitha llojet e matësive të kërkuar nga ju, ndërsa nga ana tjetër nuk thoni se për cilët

matësa të kërkuar nga ju ne nuk kemi paraqitur çertifikatën MID. Për të përmbushur këtë kriter ne kemi praqitur dy dokumenta: çertifikatën TSE së bashku me raport testimin në përputhje me direktivën 2014/32/EU MID-005 për matesin ultrasonik dhe çertifikatën B/MI-001/2015-35-3-0 së bashku me raponet e testimit, trup notifikuese e çertifikuar nga Bashkimi Europian me nr.NB 1432, lëshuar nga Instituti Sllovak i Metrologjise për të gjitha llojet e matësve prodhuar nga kompania “Baylan”.

Se katërti, ne e kundërshtojmë paragrafin e katërt të skualifikimit pasi e kemi plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor. Ju kërkon që $Q1 \leq 13$ për matësit ultrasonik, ndërkohë ne kemi paraqitur në katalog në faqen 4 të tij një matës ku $Q1 \leq 40$, një matës që mat në një dhe minimale nga 0 deri deri në 40 litra, pra matës që tejkalon specifikimet teknike të vendosura nga ana juaj. Bazuar në nenin 23 të LPP, specifikimet teknike të vendosura përshkruajnë kërkesat minimale.

Së pesti, ne e kundërshtojmë paragrafin e pestë të skualifikimit pasi e kemi plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor. Autoriteti kontraktor kërkon që jetëgjatësia e baterisë, kur të dhënat e matësit ultrasonik transmetohen me valë, të jetë 11 vjet. Kjo nuk është kërkesë e vendosur në DST, por është një specifikim teknik për të cilën ne e kemi nënshkruar Deklaratën për Përmbushjen e Specifikimeve Teknike. Në mostrat e mallrave që kemi paraqitur ne kemi pasqyruar realitetin dhe qartësisht atë çfarë kompania “Baylan” prodhon, lehtësisht e verifikueshme në faqen zyrtare të kësaj kompanie. Ne nuk mund të paraqesim diçka që nuk mund ta kemi, pra menduam se për ju më i rëndësishëm është matësi, por bateria e tij është një pjesë e ndërrueshme dhe qartësisht mund të implementohet një tjetër që të mund plotësojë ato çfarë keni Specifikuar. Qartësisht kërkesa juaj në specifikime teknike është kontradiktore sepse nga njëra anë ju nuk vendosni periudhë garanci për matësin pjesë e të cilit kjo bateri është, por nga ana tjetër vendosni garanci 11 vjet jetëgjatësi për baterinë që është pjesë e matësit. Atëherë na lindin pyetjet, për ju më e rëndësishme është bateria apo matësi?! Për çfarë ju duhet bateria kur matësi në të cilin vendoset kjo bateri e ka jetëgjatësinë 2 apo 3 herë më të vogël?! Ne kemi dorëzuar mostrat ashtu siç specifikoni ju në dokumentat standarte të tenderit pjesa 2.3 Kapaciteti Teknik të shtojcës 9 pika 5 ku sipas nenit 23 të LPP specifikimet teknike që ju kërkon duhet të kishin parashikuar kërkesat minimale, të mos ishin diskriminuese apo favorizuese për kompani të caktuara. Këtë bateri më këtë nivel jetëgjatësie mund ta ketë të patentuar vetëm një prodhues i matësve dhe kjo përbën kufizim të konkurrencës dhe favorizim në tendera. Gjithashtu theksojmë se në katalogët tanë ne kemi paraqitur specifikimet minimale që matësat tanë përbushin, pra ajo bateri mund të shkojë është 20 vjet. Në kërkesat e vendosura në dokumentat standarte të tenderit pjesa 2.3 Kapaciteti Teknik të shtojcës 9 nuk na kërkohet që të japim garanci me dokumenta, deklarata apo të ndonjë forme tjetër për jetëgjatësinë e baterisë gjithashtu ju nuk e keni testuar baterinë sesa jetëgjatë ajo mund të jetë. Pasi ta keni provuar mund të thoni se nuk i përmbush specifikimet teknike.

Së gjashti, ne e kundërshtojmë paragrafin e gjashtë të skualifikimit pasi e kemi plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor. Matesi TK-5C që kemi sjellë si mostër është i njëjtë me matësin TK-3C sipas katalogut, por më i avancuar. Matësi TK-3C i plotëson dhe i tejkalonte specifikimet tuaj teknike aq më tepër matesi TK-5C. Edhe nëse rezulton ashtu si komisioni

juaj ka vërejtur, mostra është sjellë për të garantuar përmbushjen e specifikimeve teknike. Përmasa e hyrjes apo daljes së matësit, pra e konektorëve të tij, nuk jep asnjë të dhënë, si për përmbushjen e specifikimeve teknike gjithashtu edhe për të dhënat e tjera të cilësisë. Janë matesa të së njëjtës gjeneratë, thjesht është paraqitur për të përmbushur kërkesat e tenderit tuaj, që ju të shihni si specifikimet teknike ashtu edhe përmbushjen e kërkesave të tjera të cilësisë. Në rast të lidhjes së kontratës qartësisht do t'ju paraqiten matësa TK-3C që përmbushin edhe specifikat për përmasat e konektorëve. Ne kemi të drejtën ekskluzive të matësive "Baylan" në Shqipëri dhe si e tillë të drejtën që të paraqesim ofertë për të gjitha tipet e matësive të kësaj kompanie dhe nuk do të jetë problem realizimi i kontratës apo përmbushja e specifikave kaq minimale ku kemi të bëjmë vetëm me përmasa konektorësh. Diten e hapjes së ofertave është mbajtur procesverbali i dorezimit të mostrave me nr.640 Prot. Sipas këtij procesverbali operatori ekonomik Fat Group shpk ka paraqitur mangesi në mostra, ku për vulat e kerkuara ka paraqitur vul dhe tel të ndare nga trupi i vules, që është specifikuar dhe në kete procesverbal. Dhe për cudi është shpallur fitues me ofertën me të lartë të ofertuar. Subjekti jone A.M.U shpk ka paraqitur të gjitha mostrat sipas specifikave të kerkuara nga autoriteti kontraktues dhe ka paraqitur ofertën me të ulët për procedurën e zhvilluar. Interpretimi i bërë nga ana e autoritetit kontraktues është komplet diskriminues duke na skualifikuar me pa të drejtë duke i shkaktuar dhe vetë institucionit dem ekonomik dhe duke kualifikuar operatorin me ofertën me të lartë të ofertuar për kete procedure. [...]"

II.9.Në datën 06.08.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.958prot., datë 03.08.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "A.M.U" sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : [...]" - Ne dokumentin me emër "Certifikata Aprovimi për përdorim ujë të pijshëm Itecon" në faqen nr.2 nuk ka asnjë të dhënë mbi tipin e matesit që është certifikuar për ujë të pijshëm. Rrjedhimisht nuk vertetohet se matesi ultrasonic ka certificate të ujit të pijshëm[...]", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën 9, pika 2.3.8 "Kapaciteti teknik", në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“8. Matesat dhe buketonat duhet të kenë certifikate të aprovimit nga të paktën 1 institucion kombëtare, ndërkombëtare ose institucione të pavarura certifikuese/testuese për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh DVGË ose ekuivalente me te)”

III.1.2.Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterit të sipërcituar, KPP konstaton se operatori ekonomik “A.M.U” sh.p.k., ka dorëzuar:

- Certifikatë Analizë nr.17/0980, lëshuar nga laboratorit Itecon, për produktin “Matës Uji TK (1C-1S-2-2P-2S-3C-3P-3S-4C-4P-4S-5S-7C-7S-8-12-13-21-22-23-24-25-26-26S-27-28-29)” prodhuar nga kompania “Baylan” e përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar;
- Certifikatë Analizë nr.15/0135, lëshuar nga laboratorit Itecon, për produktin “Sahatë Uji Woltman të tipit (W-0, W-1, W-2, W-3, W-4,W-5,W-6)” prodhuar nga kompania “Baylan” e përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar;
- Certifikatë Analizë nr.17/0983, lëshuar nga laboratorit Itecon, për produktin “Sahatë Uji KK (1-2-3-10-11-12-12S-13-14-15-16-17-29)” prodhuar nga kompania “Baylan” e përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar;
- Certifikatë Higjene, lëshuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Polonisë, për kompaninë prodhuese Baylan Olcu Aletleri San. Ve. Tic. Ltd. Sti.

III.1.3.Në nenin 46 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : *“[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese[...]*”

III.1.4.Në nenin 30 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se *“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”*

III.1.5.Në nenin 27, pika 6, gërma c, të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: c.dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”*

III.1.6.Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7.Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike si dhe në dokumentacionin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor, nëpërmjet kësaj procedure prokurimi, ndër të tjera kërkon të blejë matësat e uji dixhital. Nga ana tjetër, autoriteti kontraktor kërkon që operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin certifikata të aprovimit nga të paktën një institucion kombëtar, ndërkombëtar ose institucione të pavarura certifikuese/testuese për përdorimin për ujë të pijshëm e të këtyre matësive, në mënyrë që të vërtetohet që këto të fundit përmbushin specifikimet teknike dhe standartet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në përmbushje të kriterit dhe kërkesave të autoritetit kontraktor, si dhe mostrave të paraqitura, Komisioni konstaton se, për artikullin e kërkuar nga autoriteti kontraktor "*Matës uji Dixhital DN32*" operatori ekonomik "A.M.U" sh.p.k ka ofertuar matësin ultrasonic të tipit U-4, të prodhuar nga kompania Baylan, kjo bazuar në autorizimin e prodhuesit, katalogun dhe mostrën e paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës. Gjithashtu, Komisioni konstaton se operatori ekonomik "A.M.U" sh.p.k, në përmbushje të kriterit pika 2.3.8 të shtojcës 9, "Kapaciteti teknik", ka paraqitur certifikata të analizave të kryera nga laboratorit Itecon, të cilat pasqyrojnë rezultatet e testimit për "Matës Uji TK (1C-1S-2-2P-2S-3C-3P-3S-4C-4P-4S-5S-7C-7S-8-12-13-21-22-23-24-25-26-26S-27-28-29)", "Sahatë Uji Woltman të tipit (W-0, W-1, W-2, W-3, W-4,W-5,W-6)" dhe "Sahatë Uji KK (1-2-3-10-11-12-12S-13-14-15-16-17-29)" prodhuar nga kompania "Baylan", por ankimuesi nuk ka paraqitur certifikatë të aprovimit nga të paktën një institucion kombëtar/ndërkombëtar ose institucione të pavarura certifikuese/testuese për përdorimin për ujë të pijshëm të matësit ultrasonic të tipit U-4 të ofruar.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se ndodhemi para faktit që operatori ekonomik ankimues "A.M.U" sh.p.k, nuk ka dorëzuar dokumentacion të plotë për të përmbushur kriterin e sipërcituar të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, pasi nuk është paraqitur certifikata e aprovimit nga të paktën 1 institucion kombëtar/ndërkombëtar ose institucione të pavarura certifikuese/testuese për përdorimin për ujë të pijshëm për njërin prej artikujve të ofertuar, përkatësisht artikullin e kërkuar nga autoriteti kontraktor "*Matës uji Dixhital DN32*".

Lidhur me pretendimin e ankimuesit se [...]Ne ju kemi paraqitur një certifikatë higjene nga Instituti Kombëtar i Higjenes në Varshavë, Poloni. Faqja e dytë e dokumentit “Certifikatë aprovimi për ujë të pijshëm Itecon”, që ju citoni është përkthimi i dokumentit të lëshuar nga Instituti Kombëtar i Higjenes në Varshavë, Poloni i cili vërteton se kompania “Baylan” i plotëson të gjitha normat higjeno sanitare. Çdo artikull që ajo prodhon nuk ka ndikime negative në shëndetin e njeriut kështu edhe matësat që janë produkt i kësaj kompanie. Pra, nëse është certifikuar kompania, rrjedhimisht janë certifikuar edhe produktet e saj sepse kompania certifikohet mbi aktivitetin dhe jo mbi emrin. Rrjedhimisht edhe matësat ultrasonic të cilët janë produkt i kësaj kompanie janë të certifikuar për përdorim pa ndikim në shëndetin e njeriut, në kontakt me ujin e pijshëm të destinuar për përdorim human.[...], Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, certifikata e higjenes e lëshuar Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Polonisë, për kompaninë prodhuese Baylan Olcu Aletleri San. Ve. Tic. Ltd. Sti, nuk mund të konsiderohet si dokument që aprovon se produktet e prodhuara nga kjo kompani mund të përdoren për ujë të pijshëm sipas standarteve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, pasi në këtë certifikatë higjene është e specifikuar në mënyrë eksplicite që ky certifikim nuk aplikohet për parametrat teknik dhe përdorimin e produktit.

Vlen të theksohet se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik ka ofertuar mallra, në përputhje me me standartet dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.8 të shtojcës 9, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, nga operatori ekonomik ankimues.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “A.M.U” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen :[...] - Modeli TK-5C i paraqitur si moster nuk është 1” sic është kërkuar nga AK-ja por nga verifikimi i KVO-se rezultoi ne permasat 1 ½ , pra nuk është paraqitur sipas specifikimeve teknike te kerkuara ne DST [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në shtojcën 9, pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: “5. Operatori ekonomik, në momentin e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë mostra të mallrave që ofron, që duhet të përmbushin specifikimet teknike. Mosdorëzimi i mostrave në momentin e hapjes së ofertave, është kusht për skualifikim”

III.2.2.Në shtojcën 10, “Specifikime teknike”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Pasqyruar ne vijim

Mates uji 1/2 dhe 3/4

Matesi i ujit për uje të ftohtë duhet të jetë sipas standarteve të Bashkimit Europian 2004/22/EC dhe kërkesave të MID ose ekuivalent.

Matesi duhet të jetë i certifikuar për përdorim për ujin të pijshëm dhe kjo të vertetohet me certifikatat përkatëse.

Numrat e në fushën e matesit që tregojnë matjen e ujit të konsumuar duhet të jenë të byllur në mënyrë hermetike, në një kase që nuk krijon kondensim për të penguar leximin dhe të jenë të ndarë në 2 ngjyra (5 numra me të njëjtën ngjyrë që tregojnë m³ dhe tre numra me një ngjyrë tjetër që tregojnë nënfishat e m³). Matesi duhet të ketë element sigurie për të dalluar nëse është ushtruar forcë mbi fushën e tij për të penguar levizjen e lire të numratorit.

Matesi i ujit duhet të ofrojë mundësinë dhe të jetë kompatibel me teknologjinë e Leximit Automatik të Matesit, të suportoje vendosjen e një moduli transmetues të të dhënave me vëllim në përputhje me standartin EN 13757-4 ose ekuivalent. Në rast se matesit do të vendoset modul për transmetim të dhënash me vëllim matesi duhet të ketë mundësinë të sinjalizojë minimalisht për: rrjedhje të ujit, ndërhyrje në seksionin lidhës ndërmjet matesit dhe modulit, shkeputjen e modulit nga matesi ose demtimin e tij, rrjedhjen e ujit në drejtim të kundërt.

Mekanizmi i matesit duhet të ketë minimalisht mbrojtje të trefishtë manjetike për siguri sa më të lartë dhe një matje sa më të mirë kundrejt interferencave të fushave manjetike të jashtme ose të brendshme. Gjithashtu leximi i të dhënave duhet të kryhet anë të një lexuesi optik dhe jo me puls manjetik, në mënyrë të tillë që përdoruesit të mos kenë mundësi të ndalojnë leximin e matesit me anë të përdorimit të magnetëve. Duke pasur parasysh se percimi i rrotullimit të turbines të matesit drejt mekanizmit të matjes bëhet me anë të fushës magnetike, matesat e ofruar duhet të kenë rezistencë të lartë ndaj ndërprerjes të transmetimit të rrotullimeve, si dhe fusha e matesit të ofrojë mundësinë për të rrotulluar 360°, në mënyrë që të bëhet leximi sa më i thjeshtë, por jo më shumë se 360°.

Matesi duhet të jetë i pajisur me filter për të ndaluar papastërtitë ose mbetjet që mund të hyjnë në mates nepermjet ujit dhe me buketonat përkatëse. Buketonat për matesat DN 15 të kenë diametër të brendshëm 15-18mm dhe gjatësi 37-40mm. Për matesat DN20 të kenë diametër të brendshëm 20-23mm dhe gjatësi 45-50mm. Buketonat të jenë të certifikuar për përdorim në uje të pijshëm.

Matesi të jetë i pajisur me teknologjinë kundër ngrirjes, në mënyrë që dhe nëse uji në të, ngrin nga temperaturat e ulta, ai të mos demtohet.

<i>Mates uji DN 15 dhe DN 20</i>					
<i>Diametri i matesit DN</i>			<i>mm</i>	<i>15</i>	<i>20</i>
<i>Rrjedha e përhershme Q3</i>			<i>m³/h</i>	<i>2.5</i>	<i>4</i>
<i>Rrjedha maksimale Q4</i>			<i>m³/h</i>	<i>3.125</i>	<i>5</i>
<i>Rrjedha indirekte Q2</i>	<i>Montim horizontal</i>	<i>R100</i>	<i>l/h</i>	<i>40</i>	<i>64</i>
	<i>Montim vertikal</i>	<i>R50</i>		<i>80</i>	<i>128</i>

Rrjedha minimale Q1	Montim horizontal	R100	l/h	25	40
	Montim vertikal	R50		50	80
Rrjedha fillestare			l/h	8	15
Raporti Q2/Q1				1.6	
Temperatura nominale e punes				T30	
Klasa e ndjeshmerise se tipeve te rrjedhjes				U0, D0	
Rregjistrimi maksimal			m3	100 000	
Rregjistrimi minimal			l	0.05	
Presioni			bar	16	
Humbja maksimale per Q3 Δp			kPa	63	
Gabimi maksimal i lejuar ndermjet Q2 dhe Q4			%	± 2	
Madhesia e filetimit				G $\frac{3}{4}$	G1

Mates uji 1" dhe 2"

Matesi i ujit per uje te ftohte duhet te jete sipas standarteve te Bashkimit European 2004/22/EC dhe kerkesave te MID ose ekuivalent.

Matesi duhet te jete i certifikuar per perdorim per ujin te pijshem dhe kjo te vertetohet me certifikatat perkatese.

Fusha e matesit qe tregone matjen e ujit te konsumuar duhet te jene te byllur ne menyre hermetike, ne nje kase qe nuk krijon kondensim per te penguar leximin dhe te kete 5 rulona me numra dhe kater shigjeta treguese. Fusha duhet te jete e mbrojtur me ane te nje kapaku dhe te jete e mbyllur direkt ne trupin e matesit per te shmangur cdo lloj nderhyrje te mundshme.

Matesi i ujit duhet te ofroje mundesine dhe te jete kompatibel me teknologjine e Leximit Automatik te Matesit, te suportojte vendosjen e nje moduli transmetues te te dhenave.

Matesi te jete I ndertuar ne dy pjese thelbesore, mekanizmi mates (neper te cilin leviz uji) dhe mekanizmi tregues hermetik (i cili perfshin fushen treguese dhe rregjistrin mekanik). Mekanizmi mates duhet te jete I ndertuar ne menyre te tille qe shperndarja e ujit te behet ne menyre uniforme per te mos pasur turbulenca te cilat ndikojne ne saktesine e matjes. Turbina e matesit te jete material polipropilene, ne menyre qe te arrihet fleksibilitet dhe mos te thyhet ne rast te rrjedhjes te ujit te intensitet te larte. Percimi I te dhenave ndermjet ketyre dy pjeseve te behet me ane te valeve manjetike, dhe per te penguar interferencat e mundshme duhet te kene dhe mbroitje manjetike.

Matesi duhet te jete i pajisur me filter ne hyrje dhe ne brendesi te tij (ne pjesen e dhomezave) per te ndaluar papastertite ose mbetjet qe mund te hyjne ne mates nepermjet ujit dhe me buketonat perkates. Buketonat per matesat DN 25 te kene diameter te brendshem 28-30mm dhe gjatesi 57-60mm. Per matesat DN 50, flanaxha te jete sipas standartit ISO7005 ose ekuivalent.

<i>Mates uji DN 25 dhe DN 50</i>					
<i>Diametri i matesit DN</i>			<i>mm</i>	25	50
<i>Rrjedha e perhershme Q3</i>			<i>m3/h</i>	6.3	4
<i>Rrjedha maksimale Q4</i>			<i>m3/h</i>	7.875	5
<i>Rrjedha indirekte Q2</i>	<i>Montim horizontal</i>	<i>R100</i>	<i>l/h</i>	100.08	64
<i>Rrjedha minimale Q1</i>	<i>Montim horizontal</i>	<i>R100</i>	<i>l/h</i>	63	40
<i>Rrjedha fillestare</i>			<i>l/h</i>	19	15
<i>Raporti Q2/Q1</i>				1.6	
<i>Temperatura nominale e punes</i>				T30	
<i>Klasa e ndjeshmerise se tipeve te rrjedhjes</i>				U0, D0	
<i>Rregjistrimi maksimal</i>			<i>m3</i>	99 999	
<i>Rregjistrimi minimal</i>			<i>l</i>	0.05	
<i>Presioni</i>			<i>bar</i>	16	
<i>Humbja maksimale per Q3 Δp</i>			<i>kPa</i>	63	
<i>Gabimi maksimal i lejuar ndermjet Q2 dhe Q4</i>			<i>%</i>	± 2	
<i>Madhesia e filetimit</i>				G 1 1/4	Fillanxhe

Mates uji Dixhital DN32

Matesi i ujit per uje te ftohte duhet te jete sipas standarteve te Bashkimit European 2004/22/EC dhe kerkesave te MID ose ekuivalent.

Matesi duhet te kete mbrojte te klasit IP 68 ose ekuivalente me te.

Matesi duhet te jete i certifikuar per perdorim per ujit te pijshem.

Matesi duhet te kete ekran dixhital per shfaqjen e te dhenave te matura dhe te kete te inkorporuar modul radio (jo te mbivendosur, pra te jene nje trup) per leximin e te dhenave ne distance nepermjet transmetimit te te dhenave sipas protokolleve OMS ose ekuivalente me te.

Matesi duhet te punoje minimumi 15 vjet me bateri pa perdorur opsionin e transmetimit te te dhenave me vale sipas protokolleve EN 13757-4 ,OMS ose ekuivalente me te dhe minimumi 11 vjet ne rastin kur transmeton te dhenat me vale. Bateria e matesit duhet te jete e zevendesueshme ne menyre qe matesi te mund te perdoret dhe per me gjate se 11 vjet.

Kushtet klimaterike qe duhet te suportojte matesi duhet te jene sipas standartit EN - ISO 4064:2014 ose ekuivalente me te.

Nepermjet transmetimit te te dhenave me vale matesi duhet te transmetojte edhe alarme ne lidhje me: Baterine (kur bateria eshte drejt shkarkimit te plote), Nderhyrje per manipulim te dhenash(heqjen e matesit te ujit nga sistemi ne menyre te pa-autorizuar), rrjedhje te vogla te ujit, rrjedhje shume te medha te ujit (mbi limitin e matesit), kur ka sasi te medha ajri ne uje, kur ska uje etj.

Bazamenti i matesit ku kalon uji te jete plotesisht i hapur ne menyre qe te mos ndikohet nga papastertite qe mund te kete uji dhe elementet mates te tij te jene te mbrojtur nga cdo lloj demtimi.

Matesi te ofroje mundesine per tu konfiguruar dhe ricertifikuar me ane te komunikimit valor. Gjithashtu matesi te ofroje mundesine qe te lexohet historiku i te dhenave dhe gabimeve me ane te nje smartphone, ose paisje tjeter ekuivalente.

<i>Mates uji elektronik DN32</i>			
<i>Diametri i matesit DN</i>		<i>mm</i>	32
<i>Rrjedha e perhershme Q3</i>	<i>Montim horizontal</i>	<i>m3/h</i>	10
	<i>Montim vertikal</i>		10
<i>Rrjedha maksimale Q4</i>	<i>Montim horizontal</i>	<i>m3/h</i>	≥ 12
	<i>Montim vertikal</i>		≥ 12
<i>Rrjedha indirekte Q2</i>	<i>Montim horizontal</i>	<i>l/h</i>	20
	<i>Montim vertikal</i>		20
<i>Rrjedha minimale Q1</i>	<i>Montim horizontal</i>	<i>l/h</i>	≤ 13
	<i>Montim vertikal</i>		≤ 13
<i>Rrjedha fillestare</i>		<i>l/h</i>	≤ 3.2
<i>Raporti Q2/Q1</i>			1.6
<i>Temperatura nominale e punes</i>			T30
<i>Klasa e ndjeshmerise se tipeve te rrjedhjes</i>			U0, D0
<i>Rregjistrimi maksimal</i>		<i>m3</i>	1 000
<i>Rregjistrimi minimal</i>		<i>l</i>	0.01
<i>Presioni</i>		<i>bar</i>	16
<i>Humbja maksimale per Q3 Δp</i>		<i>bar</i>	0.4
<i>Gabimi maksimal i lejuar ndermjet Q2 dhe Q4</i>		<i>%</i>	± 2
<i>Madhesia e filetimit te matesit</i>		<i>inch</i>	G1 1/2"
<i>Madhesia e buketonit</i>		<i>inch</i>	G1 1/4"
<i>Gjatesia e buketonit</i>		<i>mm</i>	55-60

III.2.3.Në, në nenin 53/3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.2.4.Në nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a)mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimitdhe/ose”

III.2.5.Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues dhe të administruara autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, nuk është paraqitur mostër për artikullin *Matës uji 1*” e kërkuar në dokumentat e tenderit objekt shqyrtimi nga autoriteti kontraktor. Ky fakt është pranuar edhe nga vetë operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur prej tij pranë autoritetit kontraktor dhe KPP, me pretendimin se “*Përmasa e hyrjes apo daljes së matësit, pra e konektorëve të tij, nuk jep asnjë të dhënë, si për përmbushjen e specifikimeve teknike gjithashtu edhe për të dhënat e tjera të cilësisë. Janë matesa të së njëjtës gjeneratë, thjesht është paraqitur për të përmbushur kërkesat e tenderit tuaj, që ju të shihni si specifikimet teknike ashtu edhe përmbushjen e kërkesave të tjera të cilësisë. Në rast të lidhjes së kontratës qartësisht do t’ ju paraqiten matësa TK-3C që përmbushin edhe specifikat për përmasat e konektorëve.*”

III.2.6.KPP gjykon se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentat e tenderit përbën shkak për skualifikim. Komisioni thekson se autoriteti kontraktor ka kërkuar në mënyrë eksplicite paraqitjen e mostrave fizike sipas specifikimeve teknike për cdo artikull të kërkuar dhe nuk e ka lënë në asnjë rast të hapur mundësinë për të paraqitur artikuj të tjerë referues në mungesë të mostrës fizike sipas specifikimeve teknike të përcaktara. Referuar legjislacionit në fuqi, mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve teknike të kërkuara, për vënien në funksion të tyre. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk e ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 9, pika 2.3.6, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “A.M.U” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori

ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "A.M.U" sh.p.k. mbi mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik "Fat Group" sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.4.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar), parashikon se: *"Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin."*

III.4.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërisht nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi. Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "A.M.U" sh.p.k për procedurën e prokurimit, *"Procedurë e Hapur"*, me objekt *"Blerje matësa uji"*, me nr. REF-70464-05-22-2018, me fond limit 16,910,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.06.2018, nga autoriteti kontraktor Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1320 protokoli Datë 26.07.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

